



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1502 Prot

Roskovec, më 07.03 2023

**Lënda:** Rezultatet e Sondazhit të Prioriteteve të Komunitetit të Bashkisë Roskovec

**Drejtuar:** Znj. Majlinda Bufi, Kryetare e Bashkisë

**Për dijeni:** Anëtarëve të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Roskovec

**E nderuar znj. Kryetare**

Komisioni i i Ekonomisë dhe Financës, i mbledhur me datën: 06.03.2023 pasi shqyrtoi dhe analizoi rezultatet e sondazhit të prioriteteve të komunitetit për Projektbuxhetin Afatmesëm 2024-2026, kërkon reflektimin e prioriteteve kryesore që kanë dalë nga ky sondazh.

Sondazhi i hartuar dhe i organizuar nga Këshilli Bashkiak dhe i publikuar në faqen e internetit, dhe facebook-un e Bashkisë dhe të Këshillit ka si qëllim të sjellë zërin qytetar dhe të grupeve të interesit pranë pushtetit lokal dhe mundësisht të përfshijë disa nga këto prioritete në buxhetin 2024 si pjesë e Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 brenda kapaciteteve financiare dhe prioriteteve strategjike të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Këshilli i Bashkisë, pasi analizoi rezultatet e sondazhit, vëren se funksionet e përfshira në programet e mëposhtme janë konsideruar prioritare nga shumica e të anketuarve në sondazh:

- Programi 04130: Mbështetje për zhvillim ekonomik
- Programi 04220: Shërbimet bujqësore
- Programi 06370: Furnizimi me ujë dhe kanalizime
- Programi 05100: Menaxhimi i mbetjeve

Për sa më sipër, rekomandojmë që gjatë procesit të përgatitjes së tavaneve përgatitore për PBA 2024 – 2026, Bashkia të marrë parasysh dhe të reflektojë rekomandimet e komunitetit, duke planifikuar më shumë fonde për programet prioritare të sipërpërmendura me qëllim përfshirjen e mendimit dhe sugjerimeve qytetare në hartimin e dokumentave të rëndësishëm financiar të Bashkisë Roskovec.


Komisioni pret reagimin Tuaj në lidhje me kërkesat e komunitetit përpara se të miratojë draftin e parë të PBA-së në muajin Mars.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !

Kryetar i Këshillit Kadri Hyska



Kryetar i Komisionit Leksi Goga



Sekretari i Këshillit Arlinda Hajdini

